

Banka Për Biznes, Zyra Qendrore në Prishtinë shpall konkurs për pozitën:

KONKURS

Menaxher i degës në Dragash (m/f)

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare (*Preferohet Bachelor në Ekonomi, Administrim Biznesi, Banka dhe Financa apo Menaxhment*);
- Përvojë e mëparshme jo më pak se 5 vite në sistemin bankar;
- Njohuri të procesit të kredive, operacioneve dhe produkteve bankare;
- Aftësi të shkëlqyeshme analitike, të komunikimit dhe prezantimit;
- Aftësi të shkëlqyeshme të planifikimit, organizimit dhe menaxhimit të kohës;
- Vetë-motivues dhe i shkathët me fokus në mbylljen e veprimeve/planifikimeve me sukses;
- Aftësi të shkëlqyera të menaxhimit të kohës, prioriteve dhe arritjes së objektivave;
- Nivel i avancuar i Gjuhës Angleze dhe përdorimit të paketës së Microsoft Office dhe Outlook.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Udhëheq degën dhe menaxhon punëtorët e degës;
- Organizon dhe koordinon me procesin e punëve;
- Kujdeset për realizimin e planit të biznesit;
- Koordinon promocionet me punëtorët e degës;
- Takon klientë ekzistues si dhe ata potencial;
- Monitoron kthimin e të gjitha llojeve të kredive;
- Kujdeset për mbarëvajtjen e të gjitha proceseve ditore të punës;
- Zbaton politikat dhe procedurat e bankës në nivel të degës;
- Propozon ndryshime në procese, procedura dhe punë ditore për rritjen e efikasitetit të punës;
- Përcjellë vazhdimisht gjendjen e likuiditetit të degës;
- Mbikëqyr afarizmin bankar të degës, përkatësisht pasqyrat financiare (P&L) të degës;
- Nënshkruan dokumentet e bankës varësisht prej nivelit të autorizimit;
- Zbaton dhe përcjellë udhëzimet nga menaxhmenti, zyra qendrore, auditorët e brendshëm, auditorët e jashtëm dhe struktura tjera relevante;
- Kryen edhe punë tjera të rëndësishme për bankën të parapara nga udhëheqësit në zyrën qendrore;

Procedura e aplikimit:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi plotësoni formularin për aplikim duke bashkëngjitur dhe CV-në tuaj, në këtë link: <https://www.bpbbank.com/forma-e-aplikimit-per-punesim/>

Pas seleksionimit të dokumentacionit do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë. Afati i aplikimit është deri me datë: **8 tetor 2020**. CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.